



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

Histori shqiptare në Torino- ALBANIAN STORYTELLING Letërsia shqipe në Sallonin Ndërkombëtar të Librit

2018-05-07 14:06:00



ALBANIAN STORYTELLING/ L'Albania dei giovani scrittori Me këtë titull histori shqiptare do të rrëfehen në Torino, krijimtari e autorëve të rinj. Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Departamentin e Kulturës së Rajonit të Pulias, me Fondacionin Gramsci dhe Qendrën Shqiptare të Torinos organizojnë prezantimin në Sallonin Ndërkombëtar të Librit në Torino të pesë autorëve të rinj nga Shqipëria, fitues të projektit “Fondi për mbështetje të krijimtarisë letrare, 2017” të mbështetur nga Ministria e Kulturës.

ALBANIAN STORYTELLING/ L'Albania dei giovani scrittori

Me këtë titull histori shqiptare do të rrëfehen në Torino, krijimtari e autorëve të rinj. Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Departamentin e Kulturës së Rajonit të Pulias, me Fondacionin Gramsci dhe Qendrën Shqiptare të Torinos organizojnë prezantimin në Sallonin Ndërkombëtar të Librit në Torino të pesë autorëve të rinj nga Shqipëria, fitues të projektit “Fondi për mbështetje të krijimtarisë letrare, 2017” të mbështetur nga Ministria e Kulturës.

Ministria e Kulturës në zbatim të politikave për promovimin e letërsisë shqipe ka krijuar tashmë disa programe vjetore në mbështetje të letrave shqipe si brenda dhe jashtë vendit. Një nga projektet që ka ndihmuar në realizimin e veprave dinjitoze të letërsisë shqipe është dhe “Fondi në mbështetje të krijimtarisë letrare” përmes së cilit mbështeten autorët në procesin e tyre krijues. Vitin e kaluar iu dha përparësi mbështetjes së letërsisë së krijuesve të rinj, me qëllim evidentimin e zërave të rinj në letërsinë shqipe. Përmes këtij fondi u mbështetën 5 autorë shqiptarë deri 35 vjeç. Ministria e Kulturës përveç mbështetjes në realizimin dhe botimin e veprave, ka ndihmuar edhe promovimin e autorëve të rinj në panairë dhe festival, si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Në vijim të kësaj nisme Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Rajonin e Pulias, me Fondacionin “Antonio Gramsci” dhe shtëpinë botuese “Salentobooks” do të organizojnë prezantimin e pesë autorëve të rinj nga Shqipëria në Salonin Ndërkombëtar të Librit në Torino. Është e para herë që hartohet një program i posaçëm për autorët e rinj, me qëllim përkthimin dhe botimin e veprave më të mira në gjuhën italiane. Projekti i titulluar “Albanian Storytelling” synon të shtrihet në kohë dhe të vende të ndryshme.

Autorët pjesmarrës:

1. Saimir Muzhaka, përfitues i Fondit të Krijimtarisë Letrare me romanin “Qyteti plak”.
2. Eris Rusi, përfitues i Fondit të Krijimtarisë Letrare me vëllimin me tregime “Ëndrra e fundit e natës”.
3. Manjola Nasi, përfituese e Fondit të Krijimtarisë Letrare me vëllimin me poezi “Një udhëtim e gjysmë”.
4. Elona Çuliq, përfituese e Fondit të Krijimtarisë Letrare me vëllimin me poezi “Rranjët e kangës”.
5. Belfjore Qose, përfituese e Fondit të Krijimtarisë Letrare me vëllimin me poezi “Aurat e natës”.

Autorët do të paraqesin krijimtarinë e tyre në dy takime:

Letërsia shqipe në Sallonin Ndërkombëtar të Librit në Torino do të prezantohet në datat 10 – 12 maj 2018.

10 maj, ora 16.30, në stendën e Rajonit të Pulias në Sallonin

Ndërkombëtar të Librit në Torino;

10 maj, ora 20.30 në Salone Off, në “Pale del 900” Via del Carmine 14

Torino;

Link: http://www.saloneibro.it/it/?option=com_content&view=article&id=21227:albanian-storytelling-18976&catid=302:2018